

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fetoshi: Vendimi i Hagës, një pikë kthese historike për Kosovën
ADRESA	https://albeu.com/kosove/fetoshi-vendimi-i-hages-nje-pike-kthese-historike-per-kosoven/1012765/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:08:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:06:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d679d606b77a6b8fffc5b467bc8778c0d8734a3e8c70a69b7b99df4636f621c3
TEKSTI	778d251fe11aaa7b8c677e6dc23eca3b48706cc68fb443ba71e37522a62fc619
PAMJA	712a8492065116ae3bb06cddb7fdd12a34b6ea1ca49b82866c6131d95d6e1c39

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6fe5676d0501bcb3a6c9786f7717056221c4d6c59f9ace4433985232846c0822
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6fe5676d0501bcb3a6c9786f7717056221c4d6c59f9ace4433985232846c0822>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fetoshi: Vendimi i Hagës, një pikë kthese historike për Kosovën



Një ditë përpara vendimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin, drejtori i Institutit "Octopus", Arben Fetoshi, e ka cilësuar procesin gjyqësor në Hagë jo vetëm si një padrejtësi të mundshme ndaj individëve të akuzuar, por edhe si një përballje të gjatë juridike për të vërtetën rreth Kosovës.

Fetoshi ka deklaruar se 16 shtatori përbën një datë me peshë historike për Kosovën dhe rendin euro-atlantik në Ballkanin Perëndimor. Sipas tij, dëshmitë e ish-zyrtarëve të lartë ndërkombëtarë kanë dobësuar pretendimin e ZPS-së për ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale.

Këto qëndrime ai i ka paraqitur në analizën me titull "Verdikti i Hagës – UÇK-ja dhe beteja gjeopolitike për Republikën e Kosovës", ku ka bërë dallimin mes krimeve që mund të jenë kryer gjatë luftës dhe pretendimit se udhëheqja e UÇK-së kishte krijuar një projekt të përbashkët kriminal.

Duke i cilësuar dëshmitë e ish-zyrtarëve ndërkombëtarë si një prej zhvillimeve më të rëndësishme të procesit, Fetoshi ka vlerësuar se Prokuroria nuk ka mundur të dëshmojë as lidhjen e të akuzuarve me qëllimin e përbashkët kriminal dhe as përfshirjen e tyre në zbatimin e tij.

Sidoqoftë, ai thekson se rëndësia e 16 shtatorit nuk përcaktohet vetëm nga vendimi që do të marrë trupi gjyqësor.

"Serbia dhe Rusia kanë përgatitur shfrytëzimin e secilit skenar në strategjinë e tyre revizioniste. Lufta narrative për 'UÇK-në kriminale' dhe 'agresionin e NATO-s' në vitin 1999, do të vazhdojë me retorikën e 'Perëndimit të padrejtë', duke ashpërsuar 'viktimizimin' me 'Kosovën represive ndaj serbëve', në rastin e vendimit lirues, derisa në të kundërtën, gjithçka do të interpretohet si konfirmim i tezave të tyre, me pretendimin që të korrigjohet historia", thuhet në analizën e tij.

Në këtë kuadër, Fetoshi ka interpretuar edhe ndryshimin e deklaratave të presidentit serb, Vuçiq, i cili fillimisht foli për një vendim "krvesisht lirues". më pas për një "paralaimërim dhune" dhe në fund për një "dënim të rëndë".

të fundit /



Fetoshi: Vendimi i Hagës, një pikë kthese historike për Kosovën



Thirrjet për dhunë para vendimit të Hagës – a rrezikojnë ato pozitën...



Eksperti Shala: 16 shtatori kërkon vigjilencë, por nuk...



Gjykata e Brazilit miraton ekstradimin e Ervin Matës



Ndërpritjen negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së



Qytetarët pranë moshës së pensionit mund të blejnë deri n...



BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucion...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"E para, për ta përgatitur sulmin ndaj drejtësisë ndërkombëtare si 'e njëanshme', duke mos e pranuar vendimin e pafajësisë, ndërsa e dyta, për ta përgjithësuar dënimin eventual ndaj UÇK-së, si konfirmim nga Haga për 'të vërtetën' e tyre të 'përndjekjes dhe terrorit' ndaj serbëve.

"Udhëheqja kriminale" e UÇK-së do të kornizohet si "luftë kriminale", për ta "vërtetuar" ndërhyrjen "e padrejtë" të NATO-s", vlerëson Fetoshi, duke e lidhur këtë rrezik gjeopolitik me synimet serbo-ruse për rishikimin e historisë së luftërave në ish-Jugosllavi.

Shtuar më 15.09.2026 16:06

Tags: [Arben Fetoshi](#), [haga](#), [vendimi](#)



Dy muaj shtesë paraburgimi për Veselin dhe Krasniqin një ditë par...



Thirrjet për dhunë para vendimit të Hagës – a rrezikojnë ato pozitën e t...



Eksperti Shala: 16 shtatori kërkon vigjilencë, por nuk nënkupton...



Ndërpritën negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së



BIK-u urdhëron ekspozimin e flamurit të UÇK-së në institucionet dhe xhamitë ...



Sa ndikojnë protestat dhe kërcënimet në vendimin e gjykatës për ish-...



KDI i kërkon Gjykatës Kushtetuese masë të përkohshme për Kuvendi...



Kërkohet masë e përkohshme nga Kushtetuesja për...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.